



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.28.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AUTORITETIT KOSOVAR TË
KONKURRENCËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi pasqyrat vjetore financiare të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderren, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga Edona Abazi (Udhëheqëse e Ekipit) dhe Alban Beka (Anëtar i Ekipit).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm.....	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	20
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Bordin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe stafin e tyre për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2013 është ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 03 dhjetor 2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyrat financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013, pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar).*

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se, edhe përkundër përpjekjeve të Autoriteti Kosovar të Konkurrencës për të përmirësuar kontrollet e brendshme, ato edhe më tutje nuk janë në nivelin e duhur.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit janë relativisht të mira. Realizimi i buxhetit ishte në një nivel të arsyeshëm, përveç kategorisë së investimeve kapitale, për të cilën kërkohet një zhvillim i mëtejshëm i procesit buxhetor.

Si fusha specifike për përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm të kontrolleve të brendshme mbeten menaxhimi i stafit (për plotësimin e pozitave të lira) dhe menaxhimi i pasurisë.

Ndërsa, nga aspekti i rëndësisë më të ulët kontrolle shtesë nevojiten edhe të procedurat e prokurimit, dhe menaxhimi i shpenzimeve të cilat nuk kërkojnë prokurim (avanset).

Rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm janë si në vijim:

Kryetari i Bordit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës duhet të siguroj se:

- Plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar, dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Menaxhmenti në baza të rregullta;
- Janë marrë masa konkrete për plotësimin e vendeve të lira të punës, me qëllim të përmbushjes së objektivave dhe misionit;
- Janë marrë masat e duhura që para përfundimit të mandatit të secilës pozitë në entitet, të bëjë kthimin e pasurive nga zyrtarët e ngarkuar me pasurinë në fjalë; dhe
- Janë vendosur procedura përkatëse për të siguruar menaxhimin dhe shfrytëzimin efikas të automjeteve zyrtare.

Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF-ve dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë raporti më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

AKK, ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar)**.

¹ Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh nëse:

- PVF-të janë përgatitur në pajtueshmëri me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Janë përmbushur të gjitha kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048;
- PVF-të janë pranuar në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- AKK, ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore në Ministri të Financave (MF) gjatë vitit 2013.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrimi

Përveç hartimit të PVF-ve, nga AKK kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë Pasqyrat Nëntëmujore Financiare;
- Raportimet mbi ecurinë e projekteve kapitale;
- Draft plani i prokurimit;
- Raportet mbi obligimet e papaguara; dhe
- Plani për implementimin e rekomandimeve.

AKK ka arritur të përmbushë të gjitha kërkesat për raportim të jashtëm me kohë, me përjashtim të pasqyrave nëntëmujore financiare (PNF). Arsyeja e mos raportimit të PNF-ve ishte mungesa e ZKF-së, pasi që ishte i nominuar si kandidat për deputet në zgjedhjet lokale. Megjithatë në fund të vitit kishte dorëzuar PVF-të në pajtueshmëri me rregullat financiare.

Ne nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Në aspektin e adresimit të rekomandimeve, shohim se është bërë një progres nga ana e menaxhmentit të AKK-së. Megjithëse, kjo nuk është e mjaftueshme në raport me kërkesat e auditimit. Andaj menaxhmenti duhet të jetë i gatshëm të marr përgjegjësitë për të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të AKK-së ka rezultuar me 14 rekomandime. AKK kishte përgatitur planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve, por nuk kishte arritur ta dërgonte me kohë në ZAP.

Nga rekomandimet e dhëna, nëntë prej tyre janë adresuar plotësisht dhe pesë nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 1 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Rekomandimet e pa adresuara ndërlidhen me menaxhimin dhe raportimin e buxhetit (raportimin sipas kërkesave ligjore, lidhjen e kontratave për shërbime adekuate, plotësimin e pozitave të lira të parapara me buxhet dhe shfrytëzimin e automjeteve).

Rreziku Dështimi për t'i adresuar rekomandimet mbi sistemet kyçe financiare kishte rezultuar në:

- Dobësi të vazhdueshme në ekzekutimin e buxhetit;
- Dobësi në evidentimin e vonesave në përmbushjen e kontratave; dhe
- Kontrollë të dobëta në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Rekomandimi 1 Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve të AP-së me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar, dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga menaxhmenti në baza të rregullta.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është e fokusuar në kuptimin dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti, për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe të kontrollit. Ne vlerësojmë nëse kontrollet janë dizajnuar mirë, janë implementuar sipas planit apo funksionojnë në mënyrë efektive. Për ta bërë këtë, nevojitet vlerësimi i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të paraqitura nga menaxhmenti. Ne konsiderojmë çështje të veçanta siç janë: aplikimi i vetë-vlerësimit të MFK-së dhe vlerësimi i rrezikut.

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se AKK edhe përkundër përpjekjeve për të përmirësuar kontrollet e brendshme, ato edhe më tutje nuk janë në nivelin e duhur.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit janë relativisht të mira. Realizimi i buxhetit ishte në një nivel të arsyeshëm, përveç kategorisë së investimeve kapitale, për të cilën kërkohet një zhvillim i mëtejshëm i procesit buxhetor.

Si fusha specifike për përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm të kontrolleve të brendshme mbeten menaxhimi i stafit (kompletimi i numrit të të punësuarve) dhe menaxhimi i pasurisë.

Ndërsa, nga aspekti i rëndësisë më të ulët kontrolle shtesë nevojiten edhe të procedurat e prokurimit, dhe menaxhimi i shpenzimeve të cilat nuk kërkojnë prokurim (avanset).

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për AKK-në dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	255,043	210,603	187,471	194,165	195,693
Granti i Qeverisë -Buxheti	255,043	210,603	187,471	194,165	195,693

Nga tabela më lartë vërejmë se kemi një reduktim të buxhetit final nga ai fillestar për 44,440€. Reduktimi ishte bërë për shkak se AKK nuk kishte arritur të plotësoj numrin e të punësuarve sipas buxhetimit paraprak.

AKK gjatë vitit 2013 ka shpenzuar 187,471€ apo 89% të buxhetit final. Krahasuar me realizimin e buxhetit të vitit 2012 (prej 79%), ky nivel i shpenzimit për vitin 2013 është dukshëm më i mirë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	255,043	210,603	187,471	194,165	195,693
Pagat dhe Mëditjet	166,616	122,176	107,038	100,040	90,808
Mallrat dhe Shërbimet	82,727	82,727	77,985	92,005	101,915
Shpenzimet Komunale	5,700	5,700	2,448	2,120	2,970

Sipas kategorive ekonomike vërehet një realizim i mirë i buxhetit (kategoria e pagave dhe mëditjeve me 88% dhe të mallrat dhe shërbimet me 94%). Përfundimisht nga kjo bënë kategoria e shpenzimeve komunale me një realizim prej 43%, mirëpo për nga vlera nuk paraqet ndonjë çështje me rëndësi materiale.

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

AKK realizon të hyra nga kompanitë që veprojnë në Kosovë, varësisht nga kërkesat për përqendrimin³ e tyre. Totali i të hyrave të mbledhura gjatë vitit 2013 ishte 6,400€. Ne kemi testuar, nëse AKK ka bërë barazimet në mes raporteve të Bankës Qendrore, raporteve të Thesarit, si dhe raporteve të brendshme.

Këto të hyra inkasohen në përputhje me U.A nr. 06/2012 për mënyrën e paraqitjes së kërkesës, dhe kriteret për konstatimin e përqendrimit të ndërmarrjeve.

Rekomandimet

Ne nuk kemi asnjë rekomandim në këtë fushë.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Nga shpenzimet të cilat kanë kaluar përmes procedurës së prokurimit, ne kemi testuar tetë lëndë, në vlerë prej 17,253€.

Po ashtu, ne kemi testuar 21 pagesa në vlerë 23,435€ të blerjeve, të cilat kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit.

³ Marrëveshje e kompanisë me AKK-në, për parandalimin e shpërdorimit të pozitës dominuese në treg, si furnizues ose blerës i disa llojesh të caktuara të mallrave ose shërbimeve, në një ose më shumë ndërmarrje me pozitë dominuese.

Çështja 2 - Zhvillimi i procedurave të prokurimit në mungesë të deklaratës për disponueshmërinë e fondeve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Plotësimi i formularit standard 'Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve', bëhet me qëllim të konstatimit të nevojave dhe disponimit të fondeve. Aprovimi për inicim të aktivitetit të prokurimit do të evidentohet me nënshkrimin e saj nga ZKA dhe ZKF. Gjatë vitit 2013, AKK në asnjë procedurë të prokurimit nuk kishte përdorur këtë deklaratë.
- Rreziku** Hyrja në kontratë pa plotësuar formën e disponueshmërisë së fondeve, rritë rrezikun që AKK mos të ketë fonde të mjaftueshme për kryerjen e aktiviteteve.
- Rekomandimi 2** Kryetari i Bordit duhet të siguroj që para fillimit të aktivitetit të prokurimit të plotësohet forma për deklaratën e disponueshmërisë së fondeve, dhe të nënshkruhet nga të gjithë zyrtarët përgjegjës.

Çështja 3 - Mos informim i OE-së së pasuksesshme - Prioritet i mesëm

- E gjetura** LPP parasheh që pas përzgjedhjes së operatorit ekonomik fitues, duhen të njoftohen të gjithë Operatorët Ekonomik (OE) të pasuksesshëm. Mirëpo, pas kryerjes së vlerësimit nga ana e komisionit përgjegjës, zyrtari i prokurimit nuk kishte njoftuar OE-të e pasuksesshëm lidhur me dhënien e kontratës.
- Rreziku** Mos informimi i OE-së së pasuksesshëm, rritë rrezikun për mungesë të transparencës, dhe kufizon mundësinë për ushtrimin e ankesës së tyre në Organin Shqyrtues të Prokurimit.
- Rekomandimi 3** Kryetari i Bordit duhet të siguroj një proces të përhershëm të informimit të OE-së e pasuksesshëm. Kjo do ta zhvilloj transparencën dhe konkurrencën në blerje, dhe me këtë rast të njëjtëve ju ofrohet mundësia e ankesës.

Çështja 4 - Shfrytëzimi i shërbimeve të telefonisë mobile pa kontratë - Prioritet i mesëm

Rreziku AKK, shfrytëzon kartela mbushëse nga operatori i telefonisë mobile “Vala” me të cilën nuk kishte kontratë të nënshkruar. Për vitin 2013 për këtë qëllim janë shpenzuar 6,780€. Vlen të theksohet që i njëjti rast qëndron si rekomandim edhe në vitin e kaluar.

Rreziku Mënyra aktuale e furnizimit me mbushje të telefonisë mobile nuk siguron shërbime efikase dhe ekonomike.

Rekomandimi 4 Kryetari i Bordit duhet të shqyrtoj mundësinë që përmes procedurave të prokurimit të lidhë kontratë për shërbime të telefonisë mobile. Lidhja e kontratës do të siguroj shërbime me kosto më të ulët.

Çështja 5 - Regjistrimi në SIMFK pas pranimit të faturës - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullave të Thesarit, para pranimit të faturës, duhet që paraprakisht të procedohet urdhërblerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa në fjalë.

Mirëpo, AKK nuk kishte zbatuar këto rregulla gjatë procesimit të shpenzimeve për pagesë. Urdhërblerja është bërë pas pranimit të faturës.

Rreziku Kryerja e pagesave për mallra dhe shërbime para se të përcaktohen kërkesat/nevojat, mund të rezultojë që të pranohen mallra të cilësisë dhe sasisë jo të nevojshme.

Rekomandimi 5 Kryetari i Bordit duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFP dhe me rregulla të Thesarit.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne kemi testuar 25 pagesa në vlerë prej 32,793€. Ne vërejtëm se pagesat e testuara ishin procesuar në pajtueshmëri me kërkesat ligjore, me përjashtim të çështjes në vijim:

Çështja 6 - Mos mbyllja e avanseve me kohë - Prioriteti i mesëm

- E gjetura** U.A -2004/7 për udhëtime zyrtare përcakton që avanset të mbyllen brenda 15 ditëve pas kthimit nga udhëtimi. Te kategoria e avanseve ne testuam gjithsej shtatë mostra. Prej tyre në dy raste, avanset nuk ishin mbyllur me kohë. Shkaku kryesor ishte neglizhenca e zyrtarëve për sjelljen e dëshmive lidhur me shpenzimet e realizuara.
- Rreziku** Moszbatimi i procedurave të përcaktuara rritë rrezikun që paraja publike të përdoret në mënyrë të parregullt nga persona të caktuar.
- Rekomandimi 6** Kryetari i Bordit duhet të forcoj kontrollet financiare lidhur me menaxhimin e avanseve. Të gjithë personat që shfrytëzojnë avanse, të bëjnë barazimet e duhura brenda periudhës së kërkuar ligjore.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollet që operojnë në nivel të AKK-së, kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listat e pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Buxheti final për Paga dhe Mëditje ishte 122,176€, ndërsa numri i buxhetuar i të punësuarve ishte 23. Ndërkaq, shpenzimet e realizuara për këtë kategori ishin 107,038€, dhe deri në muajin dhjetor 2013 ishin 13 të punësuar.

Ne kemi testuar 11 mostra, duke përfshirë procedurat e rekrutimit, dosjeve të personelit, rregullsinë e pagesave, etj.

Çështja 7 – Mosplotësim i vendeve të punës - Prioritet i lartë

- E gjetura** AKK për vitin 2013 kishte të aprovuar me buxhet numrin e stafit prej 23 punonjës. Deri më 31 dhjetor ishin vetëm 13 të punësuar. Numri i punonjësve, me kërkesë nga AKK dhe i aprovuar me buxhet është 23, ku figuron edhe në vitin e kaluar.
- Rreziku** Mosplotësimi me staf i pozitive të lira shkakton vështirësi në realizimin e plotë të detyrave të AKK-së.
- Rekomandimi 7** Kryetari i Bordit duhet të siguroj se janë marrë masa konkrete për plotësimin e vendeve të lira të punës, me qëllim të përmbushjes së objektivave dhe misionit.

Çështja 8 – Vazhdimi i kontratës me vendim të Drejtorit - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas ligjit për Shërbyesit Civil, çdo nëpunës civil pas përfundimit të punës provuese me kohëzgjatje një vit, duhet t'i bëhet vlerësimi i performancës nga Drejtori i Departamentit përkatës. Me këtë vlerësim Drejtori jep rekomandim për vazhdim apo jo të kontratës së rregullt, pastaj bazuar në këtë ZKA merr vendimin përkatës.
- Për pesë punonjës ishte marrë vendimi për vazhdim të kontratës nga Drejtori i Departamentit, dhe jo nga ZKA si person i autorizuar për marrjen e vendimeve. Kjo praktikë kishte funksionuar edhe në vitet e mëhershme.
- Rreziku** Nxjerrja e vendimeve nga zyrtarët e paautorizuar, rrezikon që vendimet e marra të jenë të paqëndrueshme.
- Rekomandimi 8** Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se të gjitha vendimet lidhur me punën provuese, merren nga menaxhmenti i autorizuar për këtë qëllim.

4.5 Pasuritë dhe Detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Sipas regjistrit kontabël (SIMFK) vlera neto e pasurive të AKK-së ishte 31,390€, ndërsa pasuria jo-kapitale me vlerë nën 1,000€ ishte 39,600€.

Ne kemi testuar nëse është implementuar rekomandimi lidhur me evidentimin e pasurive nën 1,000€ dhe vendosjen e barkodeve, evidentimin e pasurive të blera gjatë vitit 2013 në regjistrat përkatës dhe harmonizimin e këtyre regjistrave me informacionet e prezantuara në PVF.

Çështja 9 - Mos kthim i pasurive nga Anëtari i Bordit - Prioritet i lartë

E gjetura Çdo zyrtar i cili është i ngarkuar me pasurinë në shfrytëzim, është i obliguar që në rast të dorëheqjes apo përfundimit të mandatit, të bëjë dorëzimin e gjithë pasurisë në posedim.

Në muajin nëntor të vitit 2013 për disa anëtar të Bordit të AKK-së ka përfunduar mandati i udhëheqjes së kësaj pozite. Njëri nga këta anëtar nuk kishte kthyer disa prej pasurive të ngarkuara, si: telefon mobil, llaptop dhe çantë për llaptop.

Rreziku Mos kthimi me kohë i pasurive nga ana e zyrtarëve, shkakton keqpërdorimin dhe humbjen e këtyre pasurive të cilat janë pronë e AKK-së.

Rekomandimi 9 Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë masat e duhura që para përfundimit të mandatit të secilës pozite, të bëjë kthimin e pasurive nga zyrtarët e ngarkuar me pasurinë në fjalë.

Çështja 10 - Mos respektimi i U.A nr.03 / 2008 gjatë shfrytëzimit të automjeteve - Prioritet i lartë

E gjetura AKK nuk ka vënë në funksion kontrolle adekuate për menaxhimin e automjeteve zyrtare. Lidhur me këtë, nuk ekziston asnjë evidencë që arsyeton shfrytëzimin e automjeteve, fletudhëtimet apo dokumentet e nevojshme për regjistrimin e kilometrave dhe shpenzimeve të realizuara.

Rreziku Mungesa e respektimit të procedurave për menaxhimin dhe përdorimin e automjeteve, rrezikon në shfrytëzim jo racional të tyre. Kjo mund të pasojë me kosto shtesë të karburanteve, si dhe shpenzimeve tjera rreth riparimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

Rekomandimi 10 Kryetari i Bordit duhet të siguroj që janë vendosur procedura përkatëse për të siguruar menaxhimin dhe shfrytëzimin efikas të automjeteve zyrtare.

4.5.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrimi

AKK në fund të vitit 2013 nuk kishte asnjë obligim për të raportuar. Të gjitha faturat e pranuar ishin paguar brenda afatit ligjor.

Gjatë vitit 2013, AKK ka raportuar obligime të papaguara në pajtim me kërkesat e rregullores financiare nr. 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore dhe në pajtim me rregulloren MF - Nr 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Në bazë të kërkesave të parapara me U.A. nr.23/2009 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), AKK nuk i plotëson kushtet për themelimin e saj.

Megjithatë, AKK kishte kërkuar nga NJAB në kuadër të MF-së të bëhet një auditim i brendshëm për vitin 2013. NJAB në kuadër të MF-së kishte caktuar një ekip të auditimit, mirëpo auditimi kishte filluar punën gjatë muajit maj 2014.

Raportin e auditimit të brendshëm dhe adresimin e rekomandimeve nga ana e menaxhmentit, do ta shqyrtojmë në vitin e ardhshëm të auditimit.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;

Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2.2. Cilësia dhe saktësia e informatave në PVF	Kryetari i AKK-së duhet të sigurojë që plani i përgatitjes së PVF-ve për vitin 2013, përfshinë rishikimin më të hollësishëm menaxherial të draft pasqyrave para se ato të dorëzohen në Qeverinë e Kosovës.	Po		
2.2. Cilësia dhe saktësia e informatave në PVF	Kryetari i AKK-së duhet të siguroj që informatat lidhur me pasuritë kontigjente janë shpalosur në shënimet përkatëse në PVF-të e ardhshme.	Po		
2.2. Cilësia dhe saktësia e informatave në PVF	Kryetari i AKK-së të siguroj që në PVF e ardhshme ka shpalosur vlerën e pasurive jo kapitale me vlerë nën 1,000€.	Po		
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari i AKK-së duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar - dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësisë më të madhe.	Po		
4.3. Kërkesat e raportimit	Të plotësohen listat kontrolluese vetëvlerësuese për të siguruar që objektivat e punës realizohen në përputhje me kërkesat e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.			Nuk është plotësuar.
4.3. Kërkesat e raportimit	Të analizoj arsyen e përsëritjes së lëshimeve dhe të ndërmarr masa adekuate që PNF e ardhshme të përgatiten në pajtim me kërkesat ligjore për raportim financiar.			Nuk është plotësuar.

4.3. Kërkesat e raportimit	Me qëllim të identifikimit të shpenzimeve të cilat duhet të procesohen përmes procedurave të prokurimit, AKK të përgatit planin e prokurimit në pajtim me kërkesat e parapara në LPP.	Po		
4.4.2. Shpenzimet tjera	Të shtohen kontrollet në sektorin e pagesave për të siguruar që shpenzimet janë klasifikuar dhe regjistruar në përputhje me planin e aprovuar kontabël.	Po		
4.4.2. Shpenzimet tjera	Të shqyrtoj mundësin e zhvillimit të procedurave të prokurimit lidhur me shërbimet e telefonisë mobile në mënyrë që të siguroj shërbime efikase me çmime më të favorshme.			Nuk është adresuar.
4.4.3. Paga dhe Mëditje	Kryetari i AKK-së duhet të siguroj që janë marr veprimet konkrete për rekrutimin e stafit me qëllim që AKK të përmbush objektivat dhe misionin.			Nuk është adresuar.
4.4.3. Paga dhe Mëditje	Kryetari i AKK-së duhet të siguroj që ka aprovuar përshtkrimet e punës për secilin zyrtarë dhe të njëjtat janë vendosur në dosjet personale dhe secili zyrtarë është informuar lidhur me detyrat e ngarkuara.	Po		
4.5. Pasuritë	Kryetari i AKK-së duhet të siguroj që janë ndërmarrë veprime konkrete për funksionalizimin e programit e-pasuria për të siguruar që informatat lidhur me pasuritë jo kapitale regjistrohen, mirëmbahen dhe raportohen në pajtim me kërkesat ligjore.	Po		
4.6. Menaxhimi i Automjeteve	Kryetari i AKK-së duhet të siguroj që procedura adekuate janë vendosur për të siguruar menaxhimin dhe shfrytëzimin efikas të automjeteve zyrtare.			Nuk është adresuar.
5. Auditimi i Brendshëm	Të shqyrtojë mundësin e sigurimit të shërbimeve të auditimit nga ndonjë institucion tjetër për të siguruar efikasitetin e kontrolleve të brendshëm.	Po		